



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**ENTI RREGULLATOR I ENERJISË**  
**BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 211, Datë 07.10.2024**

**MBI**

**RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “DEVOLL HYDROPOWER” SH.A., NË  
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “d”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “e”, 5, pika 1, gërma “e”, 13, si dhe 16 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 07.10.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1598/5 prot., datë 03.10.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “DEVOLL HYDROPOWER” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “DEVOLL HYDROPOWER” sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1588/1 prot., datë 04.09.2024, paraqiti kërkesën për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 194, datë 18.09.2024, vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 274, Seria T15/T20, të shoqërisë “DEVOLL HYDROPOWER” sh.a., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 35, datë 04.03.2015 dhe rinovuar në vijim me vendimin nr. 159, datë 29.10.2019.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 19.09.2024 dhe 20.09.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të

tretët (data 30.09.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Ky njoftim u publikua dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën nr. 1598/4 prot., datë 20.09.2024, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar vendimin për fillimin e procedurës.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të përcaktimeve të Aneksit A të Rregullores së licencimit.
- Shoqëria ka shlyer ndaj ERE-s të gjitha detyrimet për sa i përket pagesave të rregullimit.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të rinovojë licencën e shoqërisë “DEVOLL HYDROPOWER” sh.a. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 06.03.2025.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**